



YouthBankHub
WESTERN BALKAN AND TURKEY

Pjesëmarrja Politike, Sociale dhe Ekonomike e të Rinjve në Shqipëri

Raport Vjetor

A project funded
by the European Union



Implementing partners



Përmbajtja

Akronime	3
Fakte mbi Pjesëmarrjen Politike të të Rinjve	4
Fakte mbi Pjesëmarrjen Sociale të të Rinjve	5
Fakte mbi Pjesëmarrjen Ekonomike të të Rinjve	5
Përmbledhje Ekzekutive	6
Kuai Ligjor dhe Politikat	9
Grupet kryesore të interesit	11
Financimi	13
Pjesëmarrja Politike e të Rinjve dhe Sfidat	15
Fushat kryesore për advokim	17
Pjesëmarrja Sociale e të Rinjve dhe Sfidat	18
Fushat kryesore për advokim	20
Pjesëmarrja Ekonomike e të Rinjve dhe Sfidat	22
Fushat kryesor për advokim	23
Referenca	26

Akronime

AMSHC – AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

BB – BANKA BOTËRORE

BE – BASHKIMI EUROPIAN

BERZH – BANKA EUROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

INSTAT – INSTITUTI I STATISTIKAVE I SHQIPËRISË

IPA – INSTRUMENTI PËR NDIHMËN E PARA-ANËTARËSIMIT

MSA – MARRËVESHJA E STABILIZIM ASOCIMIT

SKPA – STRATEGJIA KOMBËTARE PËR PUNËSIM DHE AFTËSI

SKZHI – STRATEGJIA KOMBËTARE PËR ZHVILLIM DHE INTEGRIM

SHBA – SHTETET E BASHKUARA TË AMERIKËS

ODA – NDIHMA PËR ZHVILLIM

OECD – ORGANIZATA PËR BASHKËPUNIM EKONOMIK DHE ZHVILLIM

ILO – ORGANIZATA NDËRKOMBËTARE E PUNËS

OSHC – ORGANIZATA TË SHOQËRISË CIVILE

MDGs – OBJEKTIVAT E ZHVILLIMIT TË MIJËVJEÇARIT

SDGs – OBJEKTIVAT E ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM

PBB – PRODHIMI I BRENDSHËM BRUTO

PKVR – PLANI KOMBËTAR I VEPRIMIT PËR RININË

PNUD – PROGRAMI I ZHVILLIMIT I KOMBEVE TË BASHKUARA

PSB – PËRGJEGJËSIA SOCIALE E BIZNESIT

UN – KOMBET E BASHKUARA


UNFPA – FONDI I KOMBEVE TË BASHKUARA PËR POPULLATËN

UNICEF – FONDI I KOMBEVE TË BASHKUARA PËR EMERGJENCËN E FËMIJËVE

USAID – AGJENCIA E SHTETEVE TË BASHKUARA PËR ZHVILLIM NDËRKOMBËTAR


VET – TRAJNIMI DHE EDUKIMI PROFESIONAL

Fakte mbi Pjesëmarrjen Politike të të Rinjve




Struktura rinore	<ul style="list-style-type: none"> • 0 Ministri • 11 bashki (nga 28 të përgjigjura)
Website	<ul style="list-style-type: none"> • 20 institucione në nivel qendror nga 21 (ministri, parlamenti) • 37 bashki nga 61
Facebook	<ul style="list-style-type: none"> • 20 institucione në nivel qendror nga 21 (ministri, parlamenti) • 51 bashki nga 61
Twitter	<ul style="list-style-type: none"> • 20 institucione në nivel qendror nga 21 (ministri, parlamenti) • 7 bashki nga 61

Fakte mbi Pjesëmarrjen Sociale të të Rinjve



Fakte mbi Pjesëmarrjen Ekonomike të të Rinjve



Përmbledhje Ekzekutive

Popullsia nën moshën 30 vjeç përfaqëson rreth 40 % të popullsisë totale në Shqipëri. Ndërkohë, të rinjtë (15-29 vjeç) përbëjnë rreth 25% të popullsisë në total (INSTAT, 2016). Megjithatë, pjesëmarrja e të rinjve në sferën politike, sociale dhe ekonomike mbetet e ulët.

Nën kushtet aktuale, femrat dhe meshkujt e rinj¹ në Shqipëri janë të prirur të mbeten të pa përfshirë në politikëbërje, dhe kështu të paafte për të influencuar në statusin e tyre social dhe ekonomik.

Kështu, ky raport vë në dukje situatën ekonomike, sociale dhe politike të të rinjve shoqëruar me disa rekomandime për politikëbërësit lidhur me secilën fushë. Vlerësimi i të dhënave mbi pjesëmarrjen ekonomike, sociale dhe politike të të rinjve u fokusua në mbledhjen e disa të dhënave të rëndësishme dhe specifike në secilën fushë, të cilat mund të japin një panoramë të situatës. Nën secilin seksion të pjesëmarrjes së të rinjve në fushat e mësipërme janë listuar disa ndërhyrje advokuese të mundshme dhe rekomandime mbi politikat që duhet të ndërmerret shteti. Çdo indikator në këtë raport vlerësimi është bazuar në të dhëna sekondare. Së pari, u mbledhën të dhëna zyrtare nga institucionet përkatëse kombëtare dhe ndërkombëtare, të dhëna nga raportet e realizuara nga institucione ndërkombëtare të besueshme. Së dyti, duke qënë se për shumë indikatorë ka mungesë të dhënash, Partnerët Shqipëri dërgoi kërkesa zyrtare për informacion te institucionet përkatëse në Shqipëri. Disa të dhëna nuk janë të përditësuara për 2016, sepse institucionet përgjegjëse nuk kanë publikuar të dhëna zyrtare.

Pavarësisht progresit të bërë gjatë 25 viteve të fundit, të dhënat makroekonomike tregojnë që ka disa sfida që duhen tejkaluar në vitet e ardhshme në secilën nga tre fushat. Norma e papunësisë është 17.9%, ndërsa norma e papunësisë së të rinjve është më e lartë respektivisht 33.2% (INSTAT, 2015). Përsa i përket statusit ekonomik, 15% e të rinjve janë në risk varfërie (INSTAT, 2015).

Ka pabarazi të mëdha midis zonave rurale dhe urbane përsa i përket infrastrukturës, aksesit në shërbime, dhe të ardhura. Rreth 32.8% e të rinjve nuk janë as në punësim, as në edukim dhe as në trajnime (INSTAT, 2015). Përqindja e lartë e NEET e shoqëruar me një përqindje të lartë të të rinjve në burgje (36.54%) duhet të shërbejë si një alarm për politikëbërësit për zhvillimin e mekanizmave dhe mjeteve me qëllim përfshirjen e të rinjve në shoqëri si në

¹ Të rinj quhen të gjithë individët nga mosha 15-29 vjeç, bazuar dhe në përkufizimin e Eurostat.

sporte, arte dhe aktivitete të tjera dhe shndërrimin e tyre nga një kontigjent për krimin në qytetarë të denjë për të ardhmen. Kështu, strategjia duhet të përshtatet duke targetuar të rinjtë në disa këndvështrime.

Në lidhje me analfabetizmin e të rinjve në përgjithësi, censusi i 2011 regjistroi 8600 të rinj nga mosha 15-29 vjeç që nuk mund të lexojnë dhe shkruajnë. Një pikë tjetër e rëndësishme për tu përmendur është përfshirja sociale në praktika, aktivitete vullnetare etj. Përsa i përket përfshirjes së të rinjve në organizata të shoqërisë civile duhet të theksohet se ka një mungesë kapacitetesh në terma lidhesh, manaxhimi, dhe financimi për OSHCtë e përbëra nga të rinj, çka bën që këto organizata të jenë jo të përgatitura për mbijetesën në një mjedis me shumë kufizime. Edhe pse në përgjithësi niveli i arsimit të të rinjve në Shqipëri po rritet me shpejtësi ka ende sfida për tu tejkaluar. Mungojnë vendet e punës jo vetëm për të rinjtë me arsim të mesëm por problematika përshkallëzohet edhe më shumë për të rinjtë me arsim të lartë, të cilët nuk kanë shumë mundësi punësimi në përshtatje me nivelin dhe fushën e tyre të ekspertizës. Informaliteti dhe tregu i zi në ekonomi – i vlerësuar përafërsisht 30% e PBBsë (Boka & Torluccio, 2013) – pengon krijimin e vendeve të punës dhe redukton kushtet e atyre që janë të punësuar.

Për më tepër lidhur me pjesëmarrjen politike, të dhënat tregojnë se ka një përqindje të ulët të të rinjve në pozicione ekzekutive si ministra, zëvendës ministra në qeveri dhe në pushtetin vendor. Mungojnë strukturat rinore bashkangjitur ministrive dhe bashkive, dhe rrjedhimisht një pjesëmarrje e reduktuar në vendimmarrje. Lidhur me ndërveprimin dhe llogaridhënien nga ana e institucioneve publike, Partnerët Shqipëri bëri një monitorim të mjeteve online të përdorura nga pushteti qendror dhe ai vendor për të komunikuar me publikun. Ekziston një diferencë e dukshme midis ministrive dhe bashkive. Kështu, institucionet në nivel kombëtar i kushtojnë më shumë rëndësi marrdhënieve me publikun sesa institucioneve në nivel lokal. Edhe bashkitë që kanë mjete online për komunikimin si website, facebook, twitter reflektojnë një mungesë informacioni mbi aktivitetet e realizuara dhe mungon ndërveprimi me publikun.

Një paragraf në dokumentin e Politikave Rinore në Shqipëri nga Këshilli i Europës sintetizon disa nga sfidat e përmendura më sipër: *“Shqipëria ka një ekonomi në rritje por, për të paktën tre arsye ekziston një pozicion i pafavorshëm për të rinjtë: një treg i zi dhe informal i gjerë; një numër të diplomuarish jo në proporcion të drejtë me numrin e vendeve të punës që kërkojnë një nivel kualifikimi; dhe fakti që mosha më tepër sesa kualifikimi mbetet një faktor kyç në pozicionet drejtuese”* (Council of Europe, 2012; p.114).

Në kuadër të faktit që të rinjtë përbëjnë rreth një të tretën e popullsisë në Shqipëri, ata duhet të luanin një rol të rëndësishëm në zhvillimin e vendit. Që të ndodhë kjo, nevojitet shumë punë në disa fusha.

Përsa i përket pjesëmarrjes së ulët politike, është i nevojshëm rishikimi dhe fuqizimi i kuadrit institucional/ligjor të vendit në të gjitha nivelet, nga kombëtar në vendor, po ashtu dhe shqyrtimi i mekanizmave të qeverisjes dhe proceseve në thelb të këtyre institucioneve me qëllim kthimi i të rinjve në një faktor të rëndësishëm dhe krijimi i strukturave rinore bashkangjitur qeverisë qendrore dhe lokale. Ky kuadër duhet përfundimisht të përfshijë të rinjtë. Reformat lidhur me pjesëmarrjen politike të të rinjve, si përcaktimi i një kuote në listat e partive përmes amendamentit të Kodit Elektorale, si në çdo pesë kandidatë duhet të jetë listuar një person deri në moshën 30 vjeç. Në vijim, institucionet respektive duhet të nxiten të publikojnë të dhëna mbi pjesëmarrjen e të rinjve në zgjedhjet elektorale, të rinjtë e zgjedhur në qeverinë qendrore dhe vendore. E njëjta duhet të bëhet për OSHCtë, sepse ka një mungesë të dhënash të publikuara mbi OSHCtë e udhëhequra dhe të përbëra nga të rinj.

Në terma të pjesëmarrjes sociale, është e nevojshme të ulet numri i të rinjve në burgje përmes një strategjie afatgjatë. Rritja e aktiviteteve jashtëshkollore si klubet e sportit, artit, ku të rinjtë të ndajnë pasionet dhe interesat e përbashkëta dhe të përfshihen më shumë në jetën sociale sesa në aktivitetet ilegale dhe kriminale. Krijimi i hapësirave publike për aktivitete sportive, kulturore veçanërisht për të rinjtë do të ishin të dobishme. Me qëllim rritjen e cilësisë së arsimit duke e përshtatur me nevojat e tregut, është e nevojshme të ndërmerret një rishikim i thelluar i kurrikulës, forcimi i standarteve të mësimdhënies së mësuesve, rritja e numrit të të rinjve që kanë mbaruar arsimin dhe trajnimin profesional.

Duhet të ndërmerren disa hapa edhe për pjesëmarrjen ekonomike. Së pari është një nevojë e pakundërshtueshme për të forcuar mekanizmat për kërkimin e një pune dhe aksesin në vendet e punës, investimi në shërbime profesionale dhe ndërtimi i aftësive për kërkimin e një pune. Nga ana tjetër është i nevojshëm krijimi i një mjedisi mundësues për zhvillimin e start-up dhe vetë-punësimin, zhvillimi i aftësive sipërmarrëse si dhe lehtësimi i marrjes së kredive. Është e rëndësishme jo vetëm të krijohen më shumë fonde start-upi për sipërmarrësit e rinj, por gjithashtu bërja e përpjekjeve për promovimin e këtyre skemave për të gjithë të rinjtë që jetojnë në territorin e Shqipërisë. VET duket se është një mundësi premtuese për zhvillimin e aftësive dhe kompetencave të të rinjve në përshtatje me nevojat e tregut. Një vend me një kapital human të aftë është më i prirur të zhvillojë fabrikat prodhuese si dhe të tërheqë

investimet për zhvillim të mëtejshëm. Si rrjedhojë, kjo do të sillte dhe krijimin e vendeve të reja të punës.

Kuadri Ligjor dhe Politikat

Kuadri ligjor që rregullon pjesëmarrjen politike, ekonomike dhe sociale është i gjerë dhe i larmishëm siç janë dhe politikat në këto fusha. Një rishikim i rregulloreve dhe politikave të mëposhtme konsiderohet si thelbësor.

Në nivel ndërkombëtar:

Strategjitë për përfshirjen sociale dhe ekonomike në Shqipëri janë influencuar nga politikat dhe kuadri European, ku më të rëndësishmet janë:

- *Strategjia e BEsë për Rininë*, e cila advokon fuqishëm për “punën e të rinjve” një koncept holistik që shkon përtej punësimit dhe mbulon aspekte të ndryshme të zhvillimit personal të të rinjve. Siç është përcaktuar në Strategjinë e Rinisë të BEsë, e cila ka të bëjë me “*fuqizimin, emancipimin, përgjegjësinë dhe tolerancën [...] është gjithashtu e përcaktuar nga qëllimet më të gjera shoqërore, të cilat janë pjesëmarrja në shoqëritë demokratike, parandalimi dhe përfshirja e kohezioni social*” (European Commission, 2014, p.54).
- *Strategjia Europa 2020 për Rritje Përfshirëse, të Qëndrueshme dhe të zgjuar* – ka qëllim nxjerrjen e 20 milion njerëzve nga varfëria, luftën ndaj përjashtimit social, dhe forcimin e punësimit. Iniciativat kryesore nën këtë strategji janë Platforma kundër Varfërisë dhe Përfshirjes Sociale dhe Axhenda për Aftësi të reja dhe Vende pune.
- *Strategjia e Përfshirjes Sociale BE 2015-2020* është në thelb të Planit Kombëtar të Veprimit për Përfshirjen Sociale 2007-2016, e cila përcakton mekanizmat dhe strategjitë për përfshirje sociale gjatë ciklit të jetës së individëve si: fëmijët, individët në moshë pune, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuar, dhe komunitetet. Për më tepër, është mbështetur nga programi i Progresit, një instrument financiar që ka për qëllim zhvillimin e politikave në 5 fusha strategjike: punësimi, mbrojtja dhe përfshirja sociale, kushtet e punës, anti-diskriminimi, dhe barazia gjinore.
- *Strategjia e BEsë për Zhvillim të Qëndrueshëm* – e rinovuar në 2006, forcon zhvillimin përfshirës në ndjekje të MDGs/SDGs. Midis politikave të ndryshme që përfshin, ka një fokus të veçantë në përfshirjen sociale.

- *Instrumenti i Para-Anëtarësimit (IPA)*, 2007 dhe Marrëveshja e Stabilizim Asocimit (MSA) të firmosura në 2006, udhëheqin reformat e Shqipërisë në fusha të ndryshme politikash me qëllim arritjen e anëtarësimit të vendit në BE.
- Në nëntor të 2012, parlamenti ratifikoi *Konventën e UN mbi të drejtat e personave të paaftë*, e firmosur në 2009.

Në nivel kombëtar:

- *Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2014-2020 (SKZHI)* – përcakton një qasje të integruar për zhvillimin socio-ekonomik të vendit po ashtu dhe për integrimin në BE. Impakti që kjo strategji kërkon është në 3 këndvështrime: së pari, një zhvillim ekonomik më i madh përmes rritjes së tregut të punës, forcimit të arsimit – duke përfshirë arsimin dhe trajnimin profesional, vullnetarizmin – dhe minimizimin e ekonomisë informale. Së dyti, ka qëllim shndërrimin e rritjes ekonomike në mirëqenie sociale, përmes investimit në shërbime publike që ndihmojnë përfshirjen, kohezionin, dhe cilësinë e jetës. Aksi i tretë i strategjisë bazohet në fuqizimin e qeverisjes, demokracinë dhe parametrat e ligjit të së drejtës.
- *Strategjia për Punësim dhe Aftësi 2013-2020* ka qëllim ndërtimin e një fuqie punëtore më të arsimuar dhe të aftë sipas nevojave të tregut të punës, po ashtu dhe krijimin e më hapësirave për vende pune. Politikat prioritare të identifikuar janë: a) forcimi i mundësive të punësimit përmes politikave efektive të tregut të punës; b) ofrimi i arsimit dhe trajnimit profesional cilësor dhe trajnimit të të rinjve dhe të rriturve; c) nxitja e përfshirjes sociale dhe kohezionit territorial; dhe d) forcimi i qeverisjes së tregut të punës dhe sistemit të kualifikimeve.
- *Strategjia e mbrojtjes sociale 2015-2020* – dizenjon një plan për ndërtimin e një sistemi të mbrojtjes sociale ku individët fuqizohen dhe grupeve vulnerabël u ofrohen oportunitete që i bëjnë ata më shumë autonomë shoqëruar kjo me mekanizmat parandalues dhe të ri-integrimit në shoqëri.
- *Plani Kombëtar i Veprimit për Rininë 2015-2020* – është plani brenda strategjisë së SKZHI që targeton nevojat specifike sociale dhe ekonomike të të rinjve. Duke qënë se të rinjtë përbëjnë 1 të 3 e popullsisë dhe rreth 40% të forcës së punës në vend, plani i veprimit ka qëllim dizenjimin e politikave të tërthorta për integrimin e plotë të të rinjve në skemën e shëndetësisë, arsimit, punës sociale, dhe pjesëmarrjes politike me qëllim që ata të bëhen anëtarë aktiv të shoqërisë në të gjitha aspektet. Ky plan veprimi

është bazuar në 6 objektiva strategjik si: Nxitja e të rinjve dhe pjesëmarrja e tyre në proceset demokratike/vendimmarrje; Nxitja e punësimit të të rinjve përmes politikave efektive të tregut të punës; Shëndetësia; Sporti dhe Mjedisi; Arsimi i të rinjve; Mbrojtja sociale; Kultura dhe Vullnetarizmi.

- *Plan Kombëtar Veprimi 2010-2015 për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianë* (brenda SKZHI) – i krijuar mbi Planin Kombëtar të Veprimit 2010-2015 – Dekada e përfshirjes së Romëve. Plani është bazuar në një qasje të plotë që targeton minoritetet me qëllim përfshirjen e tyre. Kështu, politikat variojnë nga shërbime bazike si shëndetësia, arsimi, punësimi, dhe strehimi; në shërbime më të sofistikuara si mbrojtja e trashëgimisë kulturore.
- *Ligji mbi “Barazinë gjinore në shoqëri”* (i aprovuar në 2008) dhe i amenduar u prezantua në 2012. Ata paraqitën një kuotë përfaqësimi 30% për gratë në listat e kandidatit për zgjedhje, në të dyja nivelet parlamentar dhe vendor; u rritën gjobat për partitë politike nëse nuk i plotësonin këto kërkesa; u paraqit kërkesa që kuota 30% të respektohej brenda 3 pozicioneve të para në listë.

Grupet kryesore të interesit

Përfshirja sociale dhe pjesëmarrja ekonomike dhe politike janë tre fushat që kërkojnë një qasje ndër sektoriale dhe në disa nivele. Kështu, ka disa pretendentë të përfshirë në politika dhe projekte në këto tre fusha, nga aktorë privat në publik, në nivel kombëtar dhe lokal. Lojtarët kyç në këtë fusha janë:

Nivel kombëtar:

- Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë – është ministria kryesore në hartimin legjislativ dhe politikave lidhur me punësimin, arsimin profesional, mbrojtjen sociale dhe rininë.
 - Shërbimi Kombëtar i Punësimit
 - Shërbimi Social Shtetëror
 - Bordi Këshillimor Rinor
- Ministria e Arsimit dhe Sportit
 - Agjencia Kombëtare për arsim dhe trajnim profesional dhe Kualifikim
 - Qendra Kombëtare për të Mësuarin e Vazhdueshëm
- Ministri e Financës

- Ministri e Ekonomisë
 - Agjencia e Nxitjes së Biznesit Social
- Ministri e Shëndetësisë
- Ministri e Kulturës
- Instituti Kombëtar i Statistikave (INSTAT)
- Shërbimi Kombëtar Rinor dhe Shërbimi Rajonal Rinor
- Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC)
- Partitë Politike: Tre partitë politike kryesore në Shqipëri kanë krijuar forumet e tyre rinore, edhe pse niveli i aktivitetit të tyre mbetet goxha i ulët ose inekzistent në disa raste.
 - FRESSH – Forumi i të rinjve Euro Socialist Shqiptar,
 - LRI – Lëvizja Rinore për Integrim është organizatë rinore politike e Lëvizjes Socialiste për Integrim.
 - FRPD – Forumi Rinor i Partisë Demokratike
- Këshilli Rinor Shqiptar
- Parlamenti Rinor Shqiptar
- Qeveria Studentore dhe Këshilli Studentor
- Ka shumë organizata, fondacione, shoqata, grupe aktiviste rinore që promovjnë vendimmarrjen rinore, si:
 - Rrjeti i Studentëve Shqiptar jashtë vendit (AS @ N)
 - Këshilli Rinor Shqiptar
 - Parlamenti Rinor Shqiptar
 - Aksion Plus
 - Aleanca gjinore për Zhvillim
 - Qendra për të Drejtat e Fëmijëve
 - Shoqata Shqiptare e Kombeve të Bashkuara
 - SIFE Albania
 - KRIIK – Albania etc.

Në nivel Ndërkombëtar

- PNUD, UNW, UNFPA WB. OECD, USAID, EC, IOM, ILO, Olof Palme Centre;
- Ambasadat dhe agjencitë e zhvillimit të Bashkimit European, SHBA, Zvicra, Holanda, Austria, Gjermania, Italia, Greqia, midis të tjerash.
- Dhomat e tregtisë nga vendet e huaja.

Në nivel Lokal

- Departamentet rajonale/përfaqësuesit e institucioneve të lartpërmendura në nivel kombëtar luajnë një rol në zbatimin e politikave për përfshirjes socio-ekonomike në nivel lokal dhe rajonal. Kështu, ata janë përfshirë si aktorë në fushat respektive ku ata kanë një rol.
- Institucionet e qeverisë vendore – Këshilla rajonal, Bashki dhe Komuna kanë përgjegjësitë e tyre lidhur me përfshirjen sociale.

Aktorët privatë

- Shoqatat e biznesit, fondacionet e korporatave (PSB) ose filantropia nga sektori i biznesit, dhe media luajnë një rol me vlerë, duke qënë se mund të influencojnë politikën dhe/ose vendimmarrjen ndërsa financojnë projekte lidhur me përfshirjen socio-ekonomike.
- Shoqaria civile si një e tërë, por specifikisht OSHCtë, dhe donatorët janë aktorë thelbësorë në zhvillimin e politikave të përfshirjes socio-ekonomike, programeve dhe projekteve. Që pas rënies së regjimit komunist, ndihmës së huaj që erdhi në vend si asistencë financiare, ose si ndihmë teknike në reformat institucionale, hartimin e legjislacionit, ndërtimin e kapaciteteve për zbatimin e projekteve, ose përpjekjeve advokuese.

Financimi

Përfshirja sociale dhe pjesëmarrja politike dhe ekonomike është rritur përmes disa mjeteve që variojnë nga ofrimi i shërbimeve bazë sociale që nga shëndetësia dhe arsimit deri te zhvillimi i programeve specifike që targetojnë kohezionin, përjashtimin, dhe minoritetet.

Përveç strategjive të financimit me burime kombëtare (tabela 1) mbi përfshirjen politike, ekonomike dhe sociale të të rinjve, ka dhe burime ndërkombëtare nga të cilat Shqipëria përfiton. Një nga më të rëndësishmit është programi IPA i BE-së, i cili përfshin midis fushave të targetuara të ndërhyrjes: përfshirjen sociale, të rinjtë, kohezionin, arsimin, arsimin profesional dhe zhvillimin e aftësive për hyrjen në tregun e punës. Burime të tjera fondesh që mbështesin specifikisht të rinjtë janë: UNICEF, ose OSHC si Save the Children.

Tabela 1: Programet e financimit mbi Përfshirjen Sociale të të Rinjve

Politika / Programe	Afati kohor	Shpenzimet	Burimi
---------------------	-------------	------------	--------

Shëndetësia si përqindje e PBBsë	2013	5,9%	PNUD
Arsimi si përqindje e PBBsë	2013	3,3%	PNUD
Fondi i Nxitjes së Punësimit	2015	490 M lekë	Qeveria shqiptare
Ndihma zyrtare për zhvillim (ODA)	2014	2.1%	BB
Plani Kombëtar i Veprimit për Rininë 2015-2020			
Objektivi strategjik nr.1: Nxitja e të Rinjve dhe pjesëmarrja në proceset demokratike/vendimmarrje	2015 - 2020	Kosto totale e aktiviteteve të parashikuara nën këtë objektiv është 1,048,928 lekë, nga të cilat 52% është e mbuluar nga buxheti i shtetit dhe 48% janë kosto të pambuluara që mund të sigurohen nga bashkëpunimi me donator ose grupe interesi.	PKVR
Objektivi strategjik nr. 2: Nxitja e Punësimit të të Rinjve përmes Politikave Efikase të Tregut të Punës	2015 - 2020	Kosto totale e aktiviteteve të parashikuara është 6,166,247 lekë, të cilat 91% janë të mbuluara buxheti i shtetit dhe 9% janë kosto të pambuluara që mund të sigurohen nga bashkëpunimi me donatorë ose grupe interesi.	PKVR
Objektivi strategjik nr.3: Shëndetësia, Sporti, dhe Mjedisi	2015 - 2020	Kosto totale e aktiviteteve të parashikuara nën këtë objektiv është 47,062,470,000 lekë, 59% e të cilit mbulohet nga buxheti i shtetit, 1% nga UNFPA dhe 40% janë kosto të pambuluara që mund të sigurohen nga bashkëpunimi me donatorë ose grupe interesi.	PKVR
Objektivi strategjik nr. 4: Arsimi i të Rinjve	2015 - 2020	Kosto totale e aktiviteteve të parashikuara për këtë objektiv është 6,166,247 lekë, 91% e të cilave është e mbuluar nga buxheti i shtetit dhe 9% e kostove të pambuluara mund të gjenden përmes bashkëpunimit me donatorë ose grupe interesi.	PKVR
Objektivi strategjik nr.5: Mbrojtja Sociale	2015 - 2020	Kosto totale e aktiviteteve të parashikuara për këtë objektiv është 164,005,000 lekë, 40% e të cilave është e mbuluar nga buxheti i shtetit dhe 60% janë kosto të pambuluara që mund të sigurohen në bashkëpunim me donatorë ose grupe interesi.	PKVR
Objektivi strategjik nr. 6: Kultura dhe Vullnetarizmi	2015 - 2020	Kosto totale e aktiviteteve të planifikuara për këtë objektiv është 343,410,000 lekë, 60% e të cilave janë të mbuluara nga buxheti i shtetit dhe 40% janë fonde të pambuluara dhe mund të sigurohen përmes bashkëpunimit me donatorë ose grupe interesi.	PKVR
Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive 2014-2020			
Objektivi strategjik A: Nxitja e mundësive për punë të denjë nëpërmjet politikave efikase të tregut të punës	2014 - 2020	Kosto totale e aktiviteteve të planifikuara në këtë objektiv strategjik është 15,770,000 \$ përgjatë periudhës 2014 - 2020.	SKPA
Objektivi strategjik B: Ofrimi i arsimit dhe formimit profesional cilësor për të rinjtë dhe të rriturit	2014 - 2020	Kosto totale e aktiviteteve të planifikuara në këtë objektiv strategjik është 52,960,000 \$ përgjatë periudhës 2014 - 2020.	SKPA
Objektivi strategjik C: Nxitja e përfshirjes sociale dhe kohezionit territorial	2014 - 2020	Kosto totale e aktiviteteve të planifikuara në këtë objektiv strategjik është 18,000,000 \$ përgjatë periudhës 2014 - 2020.	SKPA

Objektivi strategjik D: Fuqizimi i qeverisjes së tregut të punës dhe i sistemeve të kualifikimit	2014 - 2020	Kosto totale e aktiviteteve të planifikuara në këtë objektivi strategjik është 6,900,000 \$ përgjatë periudhës 2014 - 2020.	SKPA
Shënim: Tabela e krijuar nga Partnerët Shqipëri me informacione të nxjerra nga raporte të strategjive SKPA, PKVR, raporte të UNDP, website i qeverisë shqiptare.			

Pjesëmarrja Politike e të Rinjve dhe Sfidat

Shqipëria kaloi një rrugë të gjatë me qëllim forcimin e standarteve demokratike të vendit. Proçesi është udhëhequr nga Brenda, por po ashtu është influencuar dhe nga jashtë. Proçesi i integritimit në BE është një nxitës i madh për ndryshime në fushën e demokracisë – për shembull ligji “Mbi barazinë gjinore në shoqëri”. Gjithashtu, proçesi i integritimit europian është duke forcuar një trend për institucionet publike dhe grupet politike për ta kthyer vëmendjen te të rinjtë si një grup social i vlefshëm për tu marrë në konsideratë në sferën politike. Sidoqoftë, sistemet sociale dhe politike në Shqipëri vazhdojnë të jenë në tranzicion që nga e kaluara ku pjesëmarrja politike e të rinjve nuk nxitej – disa nga këto tipare mbeten prezente dhe sot si “Një mungesë tradite demokracie, institucione të dobëta dhe shoqëri e dobët civile [...] kriminalizimi, korrupsioni dhe ekonomia informale” (Friedrich Ebert Stiftung, 2015; fq 20).

Popullsia nën moshën 30 vjeç përfaqëson një të tretën e popullsisë totale në Shqipëri. Megjithatë, pjesëmarrja e të rinjve në të dyja sferat atë politike dhe sociale mbetet e ulët. Nga të dhënat e studimit të realizuar nga Fondacioni Friedrich Ebert Foundation në Europën Juglindore, 35.8% e të rinjve marrin pjesë në disa mënyra në politikë dhe 27.7% janë aktivë në shoqërinë civile (Friedrich Ebert Stiftung, 2015). Pjesëmarrja e të rinjve në forumet rinore të partive politike mund të jetë e konsiderueshme, por ka një mungesë të të rinjve në pozicione ekzekutive dhe vendimmarrëse. Qeveria e re, e themeluar në shtator 2013, ka 21 ministra (duke përfshirë kryeministrin dhe zëvendës kryeministrin), por asnjë prej tyre nuk është nën moshën 30 vjeç. Gjithashtu, asnjë nga zëvendësministrat nuk është nën moshën 30 vjeç. Përqindja e deputetëve nën moshën 30 vjeç është 2.14% (2 femra, 1 mashkull).

Ndërkohë, përqindja e të rinjve të kandiduar për deputet në 2013 ishte 34.64% (48% femra, 52% meshkuj)². Është e dukshme se ka një diferencë të kandidatëve për deputet të rinj dhe të pëzgjedhurve si deputet në moshë të re. Dhe ky fenomen mund të ndodhë sepse të rinjtë vendosen në fund të listave të kandidimit që partitë politike dërgojnë në KQZ, çka ul shanset

² Letër zyrtare drejtuar Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve

e të rinjve për tu përzgjedhur në parlament. Një fakt tjetër që tregon pjesëmarrjen e ulët të të rinjve në vendimmarrje është mungesa e strukturave rinore bashkangjitur ministrive.

Në terma vendimmarrjeje në nivel lokal, 4.91% (3 nga 61) kryetar bashkie janë nën moshën 30 vjeç. Një indikator tjetër i vlerësuar si i rëndësishëm është pjesëmarrja e të rinjve në asamblatë qendrore të partive politike të mëdha. Asambleja e përgjithshme e Lëvizjes Socialiste për Integrim është e përbërë nga 41% të rinj nën moshën 30 vjeç, ndërsa partia demokratike ka vetëm 7% të rinj në asamblenë e përgjithshme. Partia Socialiste nuk dha të dhëna mbi përbërjen e asamblesë së përgjithshme. Lidhur me mbledhjen e të dhënave mbi strukturat rinore bashkangjitur ministrive, skuadra e kërkimit kontaktoi 61 bashki. Nga 61 bashki, vetëm 28 iu përgjigjën kërkesës. Vetëm 11 bashki deklaruan që kanë struktura rinore të krijuara.

Një e dhënë e rëndësishme e cila mungon është pjesëmarrja e të rinjve në zgjedhje. Ky është një tregues i rëndësishëm mbi pjesëmarrjen politike, dhe duhet të matet në zgjedhjet e ardhshme nga Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve.

Përsa i përket hapjes dhe llogaridhënies të qeverisë lokale dhe qendrore për të informuar dhe komunikuar me publikun dhe veçanërisht të rinjtë u realizua një kërkim mbi mjetet online të komunikimit që përdorin institucionet publike. Vihet re se pothuajse 20 nga 21 institucione publike në nivel qendror (ministri/parlament) kanë një website dhe një faqe në facebook dhe twitter. Në nivel vendor, vetëm 37 nga 61 bashki kanë një website, 51 nga 61 bashki kanë një faqe në facebook dhe vetëm 7 nga 61 bashki kanë një faqe në twitter. Pasi navigon në faqet e tyre, në përgjithësi vihet re që faqet online të bashkive nuk kanë informacion të mjaftueshëm rreth aktiviteteve të tyre; në disa raste faqet e tyre nuk janë të përditësuara; dhe ka mungesë interaktiviteti me ndjekësit.

Përveç pjesëmarrjes politike në terma të përfaqësimit në institucionet qeverisëse, ka forma të tjera të pjesëmarrjes në çështje politike dhe sociale, ku të rinjtë mund të angazhohen. Megjithëse, organizatat rinore ekzistojnë, jo shumë të rinj angazhohen në aktivitetet e tyre. Ka mungesë të dhënash mbi OSHCtë e udhëhequra nga të rinjtë. Madje për OSHCtë që përbëhen nga të rinj, ka një mungesë kapaciteti në terma lidhshmi, manaxhimi, financimi që bën që këto organizata mos të jenë të përgatitura për të mbijetuar në një mjedis ku përballen me disa kufizime – për shembull perceptimi publik nuk i mirëpret shumë aktivitetet vullnetare duke qënë se i kujtojnë epokën e komunizmit ku aktivizmi vullnetar ishte i

detyruar; mungesa e fondeve në vend rrit varësinë e organizatave nga donatorët e huaj; kuadri ligjor nuk i jep mundësinë organizatave rinore që ti përfshijnë të rinjtë në forma të ndryshme të pjesëmarrjes politike dhe civile.

Fushat kryesore për advokim

Strukturat e qeverisjes, institucionale dhe ligjore përsa i përket të rinjve dhe pjesëmarrjes së të rinjve në politikë nuk janë të zhvilluara në Shqipëri. Ka një mungesë mekanizmesh që kanë qëllim zhvillimin e interesit të të rinjve në përfshirjen e tyre në sferën publike.

Kështu, ka një nevojë për rishikim dhe forcim të kuadrit institucional/ligjor të vendit në të gjitha nivelet, nga kombëtar në lokal, po ashtu dhe shqyrtimi i mekanizmave të qeverisjes dhe proceseve në thelb të këtyre institucioneve me qëllim bërjen e të rinjve një faktor të rëndësishëm dhe krijimin e strukturave rinore bashkangjitur qeverisë qëndrore dhe lokale. Proçesi i reformës së këtij kuadri duhet të përfshijë të rinjtë. Gjithashtu, roli i strukturave ekzistuese duhet të jetë kuptimplotë dhe i rëndësishëm në proçesin e konsultimeve dhe pjesëmarrjes në vendimarrje.

- Antikorrupsioni, zbatimi i ligjit, politikat e transparencës janë miratuar vitet e fundit, por përsëri nuk gjejnë një zbatim në praktikë. Proçeset pjesëmarrëse dhe përfshirëse në vendimarrje dhe politikëbërje që përfshijnë të gjitha grupet shoqërore të interesit janë të nevojshme për të arritur një kulturë përgjegjësie të përbashkët, ndërtimin e një sensi pronësie dhe forcimin e qëndrimeve pozitive drejt një stili të rinovuar qeverisjeje.
- Reforma mbi pjesëmarrjen politike të të rinjve, si përcaktimi i kuotave në listat e partive përmes amendimit të Kodit Elektorale, si në çdo pesë kandidatë një duhet të jetë i ri nën moshën 30 vjeç.
- Preferenca për politikanë në një moshë më të madhe vihet re dhe në kuadrin ligjor dhe duhet të adresohet. Sistemi ligjor vendos një moshë minimum 40 vjeç për zgjedhjen e presidentit, e cila është e lartë krahasuar me vendet Europiane – 18 vjeç është minimumi i kërkuar për çdo pozicion në Danimarkë, Norvegji, Hollandë, Francë, Spanjë. Ky fakt i dekurajon votuesit në Shqipëri duke mos i parë politikanët e rinj si profesionistë të aftë.
- Në vijim, institucionet respektive duhet të nxiten të publikojnë të dhëna për pjesëmarrjen e të rinjve në zgjedhje dhe të rinjtë e zgjedhur në qeverinë qëndrore dhe vendore. E njëjta duhet të bëhet për OSHCtë, sepse ka mungesë të dhënash të publikuara mbi OSHCtë e udhëhequra dhe të përbëra nga të rinjtë.

- Partitë politike qëndrojnë në thelb të sistemeve demokratike, kështu me qëllim rritjen e pjesëmarrjes rinore në demokraci dhe proceset vendimmarrëse, është e rëndësishme që të përmirësohet qasja e partive politike ndaj të rinjve. Kështu, të rinjtë duhet të bëhen më shumë pjesë e organizmave të larta vendimmarrëse të partive politike. Reformat variojnë nga përbërja e partive, rregullat e brendshme, strukturat qeverisëse, programet elektorale, mekanizmat për analizën e nevojave të të rinjve dhe përfshirjen e tyre në axhendë, ose fuqizimin e forumeve të partive politike.

Pjesëmarrja Sociale e të Rinjve dhe Sfidat

Papunësia është një nga shkaqet kryesore për përjashtimin social. Sipas INSTAT (2015), norma e papunësisë për moshën 15-29 vjeç është 33.2%. Kjo është e shoqëruar me një përqindje të lartë të të rinjve në burgje (36.54%)³ nga numri i gjithë të burgosurve. Përqindja e të rinjve në burgje ndryshon në varësi të gjinisë. 99% e të rinjve në burgje janë meshkuj dhe vetëm 1% janë femra.

Ka gjithashtu faktorë të tjerë të përjashtimit social që rrisin papunësinë e grupeve të caktuara si diskriminimi bazuar te gjinia, moshja, orientimi seksual, dhe etnia. Ky rreth vicioz kërkon një qasje holistike për ta përmbysur. Sipas Komisionerit për mbrojtjen nga diskriminimi⁴, numri i raportimeve nga të rinjtë në risk diskriminimi gjatë 2015 ishte 18, përkatësisht (14) ishin subjekt i diskriminimit etnik, (1) ishte subjekt i diskriminimit gjinor dhe (3) ishin subjekt i diskriminimit për shkak të orientimit seksual. Ndërkohë gjatë vitit 2016, numri i të rinjve të raportuar në risk diskriminimi ishte 13 nga 113.

Të rinjtë me nivel të ulët arsimimi janë më të prirur për të qenë të papunë, të vuajnë nga diskriminimi dhe varfëria. Vështirësia në përfshirjen e minoriteteve në tregun e punës është pjesërisht e shkaktuar nga përqindja e lartë e analfabetizmit që karakterizojnë këto grupe, përkatësisht 40.3% Romë dhe 12.7% Egjiptianë (UNDP, 2012). Ndërsa 96% e fëmijëve shqiptarë kanë përfunduar arsimin fillor dhe 80% kanë përfunduar arsimin e mesëm, përqindja ulet në 43% dhe përkatësisht 21% për fëmijët romë (BERZH, 2016).

Përsa i përket analfabetizmit midis të rinjve në përgjithësi, censusi i vitit 2011 regjistroi 8600 të rinj nga moshja 15-29 vjeç që nuk mund të lexojnë dhe shkruajnë. Edhe të rinjtë, ata me arsim të lartë nuk kanë mundësi punësimi për nivelin dhe fushën e tyre të ekspertizës, sepse

³ Letër Zyrtare drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve

⁴ Letër Zyrtare drejtuar Komisionerit për Mbrojtjen nga diskriminimi

ekziston një mospërputhje e sistemit të arsimit dhe tregut të punës: mungesa e studimeve në tregun e punës, maturimi i tregut për disa profesione, dhe një mospërputhje e nevojave të tregut dhe sistemit aktual arsimor, çka ul shanset e punësimit për të rinjtë (CRCA, 2015).

Sidoqoftë, në përgjithësi niveli i arsimimit të të rinjve në Shqipëri është duke u rritur me shpejtësi. 35,254 të rinj janë diplomuar nga arsimi i mesëm. Përqindja e të rinjve me arsim të mesëm të detyrueshëm pësoi një rënie nga 64% në 2001 në 50% në 2011 (INSTAT, 2015). Ka një rritje të regjistrimit të të rinjve në universitete, nga 122,000 për vitin akademik 2009-2010 në 146,756 për vitin 2015-16. Rreth 173,819 studentë u regjistruan gjatë vitit 2013-2014, numri më i lartë gjatë viteve të fundit. Gjithashtu, numri i studenteve femra ka qenë më i lartë se ai i meshkujve në universitete, i cili në 2013-2014 arriti në 57%. Rritja më e madhe ndodhi jo shumë në arsimin e mesëm (nga 25% në 32%), por më shumë drejt arsimit të lartë, i cili pati një rritje nga 4% në 14%. Shkencat Humane dhe Artet ishin fushat e studimeve universitare që kishin numrin më të madh të të diplomuarve, rreth 41% të të gjithë të diplomuarve për vitin 2014. Fusha të tjera kryesore ishin Shëndeti & Mirëqenia dhe Bujqësia (secila me 13% të diplomuar), Edukimi dhe shkencat Sociale, Biznesi & Drejtësia (me nga 9%) dhe shkencat Natyrore (8%) (INSTAT 2015). Të dhënat e fundit të përditësuara tregojnë që numri i të rinjve të diplomuar gjatë vitit 2013-2014 ishte 29,137 (INSTAT, 2014).

Në praktikë, ka një diferencë të madhe midis atyre që janë regjistruar në arsimin e lartë dhe atyre që janë diplomuar. Është e rëndësishme të nxirren arsyet e kësaj difference në arsimin e lartë. Nga ana tjetër, trajnimi dhe arsimi profesional po shfaqet si një pjesë tregu pune për të rinjtë dhe si një mundësi alternative për arsimin.

Zbutja e varfërisë është një komponent thelbësor i përfshirjes sociale, dhe shpesh është konsideruar si shtylla e politikave kundër përjashtimit social. Sipas të dhënave të LSMS për vitin 2012⁵, rreth 15% e popullsisë nga moshë 15 deri në 29 vjeç ishin të varfër dhe nuk mund të plotësonin standartet bazike të jetesës (INSTAT, 2015). Sidoqoftë, varfëria është një realitet shumë dimensional, i cili përkthehet jo vetëm në terma ekonomik por gjithashtu në mungesë aksesimi në shërbime dhe ekzistencën e mirëqenies bazike dhe sigurisë. Edhe pse Shqipëria ka një ekonomi në rritje, por pabarazia është gjithmonë në rritje sipas zonave rurale dhe urbane, po ashtu dhe ndarje sociale bazuar te gjinia, moshë, normat e analfabetizimit, dhe

⁵ Për Shqipërinë, Studimi i Matjes së Standartit të Jetesës (LSMS) jep informacion mbi nivelin e varfërisë në vend.

etnia. Kështu, kohezioni social dhe parametrat e përfshirjes janë afektuar nga të gjitha dimensionet e lartpërmendura të varfërisë.

Një përgjigje e kësaj situatë është e mire detajuar në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim si më poshtë: *“reduktimi i pabarazisë në aksesin për shërbime bazë midis qendrave të qyteteve dhe rrethinave, midis zonave urbane dhe rurale, dhe midis zonave fushore dhe malore; rritja e efikasitetit të skemës së ndihmës ekonomike, e kalimit nga një skemë pasive në një skemë aktive; vendosjen e një sistemi shërbimi social efektiv dhe plotësisht operacional bazuar në principet e decentralizimit dhe de-institucionalizimit, për përfshirjen e grupeve vulnerabël në programet e mbrojtjes sociale”* (SKZHI, 2014; p.88).

Një problem tjetër i qartë për të rinjtë në Shqipëri është mungesa e përfshirjes sociale në praktika, aktivitete vullnetare etj. 19.7% e të rinjve kanë qenë pjesë e praktikave, me një diferencë të vogël midis femrave dhe meshkujve, të dominuar nga femrat. Përsa i përket përfshirjes sociale, është vënë re që vetëm 16% e të rinjve ishin të përfshirë në aktivitete vullnetare gjatë vitit të fundit në Shqipëri (Friedrich Ebert Stiftung, 2012).

Të dhëna të ngjashme janë raportuar nga Indeksi i Shoqërisë Civile 2010, ku 18% e të intervistuarve kanë kontribuar në punën vullnetare, dhe po aq janë pjesë e organizatave me profil social (IDM, 2010). Me aprovimin e ligjit Nr. 45/2016 mbi “Vullnetarizmin” pritet një rritje e përfshirjes civile dhe pjesëmarrjes së individëve në jetën sociale.

Mungesa e shanseve për të rinjtë shkakton migrim të brendshëm dhe të jashtëm: e para nga malet në zona fushore, e dyta nga zonat urbane në zonat rurale, dhe e treta nga Shqipëria jashtë shtetit. Sipas një studimi të nxjerrë nga Friedrich Ebert Foundation *“dy nga tre të rinj shqiptarë ushqejnë shpresën për emigrim”* (Friedrich Ebert Stiftung, IDRA, 2013; fq.1). Midis të rinjve që janë rikthyer, kushtet ekonomike kanë qenë arsyt dominuese pas emigrimit fillestar të tyre: mungesa e punësimit, mundësi më të mira pune, më shumë të ardhura ishin tre arsyt kryesore të emigrimit (INSTAT, 2015).

Fushat kryesore për advokim

Kuadri institucional dhe ligjor nuk fuqizon pjesëmarrjen e të rinjve në sferën sociale në Shqipëri. Ekziston një kulturë dominuese midis institucioneve publike që të rinjtë nuk do të jenë aktorët kryesorë në krijimin e të ardhmes së këtij vendi, çka është në kontrast me shpërndarjen demografike të popullsisë në Shqipëri – një nga më të rejtat në Europë.

- Në vitet e fundit janë aprovuar ligje dhe rregullore në kuadër të tranzicionit të vendit dhe kalimit në demokraci si dhe për shkak të objektivit për tu bërë anëtare e BE-së. Ende, zbatimi i disa ligjeve ose ka mbetur mbrapa, ose nuk po prodhon rezultatet e parashikuara. Për shembull, “Ligji mbi barazinë gjinore në shoqëri” dështoi në garantimin e një barazie gjinore reale në tregun e punës ose në pjesëmarrjen politike.
- Krijimi i strukturave rrjete, promovimi i bashkëpunimit ndërkombëtar dhe brenda vendit midis organizatave rinore do të mundësonte formimin e partneriteteve dhe rritjen e vizibilitetit.
- Ekspozimi dhe koordinimi me organizata të tjera kontribuon në ndërtimin e kapaciteteve të OSHC-ve të reja dhe OSHC-ve të konsoliduara.
- Përqindja e madhe e të rinjve në burgje është një çështje që duhet të adresohet përmes një strategjie afatgjatë. Kjo çështje mund të shihet në shumë dimensione. E para, forcimi i arsimit në shkollat fillore dhe të mesme dhe rritja e aktiviteteve jashtëshkollore si: klubet sportive, të artit, ku të rinjtë mund të ndajnë interes dhe pasionet e përbashkëta dhe mund të përfshihen më shumë në jetën sociale sesa në krim dhe aktivitete ilegale. Krijimi i hapësirave publike të krijuara për aktivitete sportive dhe kulturore sidomos për të rinjtë do të ishte shumë i dobishëm.

Arsimi është një fushë kryesore ndërhyrjeje për dy arsye: nga njëra anë, potenciali i arsimit si një nga shtyllat sociale që ofron mundësi për vetë zhvillim dhe autonomi, si dhe rritjen e shpresave në kërkimin e një vendi pune. Nga ana tjetër, situata aktuale lë hapësirë për përmirësim në disa aspekte të fushës së gjerë të arsimit, ku nevojitet një investim i madh.

- Me qëllim rritjen e cilësisë së arsimit duke e përshtatur me kërkesat e tregut të punës, është e nevojshme të ndërmerret një shqyrtim shterues i kurrikulës, duke rritur standartet e mësimdhënies, dhe përfshirë trajnime praktike gjatë studimeve.
- Politikat shqiptare duhet të përshtaten me politikat e BE-së me qëllim përfitimin nga mobiliteti i studentëve përmes programit ERASMUS+ si dhe rritjes së cilësisë së arsimit të lartë dhe krahasueshmërinë e diplomës përmes aplikimit të sistemit të Bolonjës. Ofrimi i shërbimit të arsimit duhet të rritë mundësinë e hyrjes dhe po ashtu cilësinë e tij, si në nivelin para universitar dhe atë universitar (SKZHI, 2013).
- Reformat në arsim duhet ta përshtasin kuadrin shqiptar me standartet, politikat dhe programet Europiane.

- Për më tepër, ekziston një nevojë për të promovuar arsimin dhe trajnimin profesional (VET). Personat me nivel të ulët arsimor e kanë shumë të vështirë gjetjen e një pune, por e njëjta gjë vlen dhe për personat me nivel të lartë arsimi, duke qënë se nuk ka mundësi punësimi që përshtaten me pritjet e tyre. Në këtë kontekst, VET ka lindur si një oportunitet për të rinjtë. Një investim i njohur në burimeve është guri themelor për rritjen e ofrimit të VET, duke maksimizuar potencialin e tij për punësimin e të rinjve.
- Një çështje tjetër për të advokuar është mungesa e të dhënave për të rinjtë në risk kujdesi të vazhdueshëm.

Pjesëmarrja Ekonomike e të Rinjve dhe Sfidat

Norma e lartë e papunësisë së të rinjve (33.2%), si dhe përqindja alarmuese prej 32.8% të rinjsh jo të përfshirë në punësim, arsim, trajnim (INSTAT, 2015) e shoqëruar me një dëshirë nga të rinjtë me arsim të lartë për tu larguar nga vendi përbën një prespektivë të errët për të ardhmen e vendit.

Ekonomia shqiptare ka ardhur duke u rritur gjatë 25 viteve të fundit, duke dyfishuar të ardhurat kombëtare bruto për frymë nga viti 1980 deri më sot. Kriza ekonomike dhe financiare globale që filloi në 2008, ndikoi ritmin e rritjes në Shqipëri. Edhe pse vendi nuk është shumë i integruar në tregjet ndërkombëtare financiare, efektet e ashpra të krizës në Greqi dhe Itali, dy partnerët kryesorë të Shqipërisë, ngadalësuan rritjen e tyre ekonomike.

Ekonomitë e dëmtuara të vendeve fqinje nuk i bëjnë dëm vetëm ekonomisë në Shqipëri në terma tregtie, por gjithashtu ulin mundësitë e emigrantëve shqiptarë për të sjellë remitanca, çka përbëjnë 8.5% të PBB në Shqipëri (BERZH, 2016). Sidoqoftë, rritja e përjetuar gjatë dekadës para krizës financiare i mundësuan Shqipërisë arritjen e një statusi me të ardhura mesatare. Sipas Bankës Botërore, varfëria ekstreme u përgjysmua nga 25.4% në 12.4% gjatë viteve 2002-2008 (Banka Botërore, 2013).

Ka një rritje të normës së papunësisë midis të rinjve nga 21.9% në 2011 në 33.2% në 2015 (INSTAT, 2015). Përqindja e papunësisë afatgjatë midis të rinjve të papunë ishte 63.1% në 2011. Kjo përqindje është më e lartë se në çdo vend të BE-së në të njëjtin vit dhe kërkon vëmendjen e duhur nga politikëbërësit. Është e nevojshme të nxirren të dhëna mbi numrin e të rinjve në përgjithësi por gjithashtu dhe mbi të rinjtë me paaftësi të punësuar në sektorin publik dhe privat, me qëllim kuptimin më shumë të sektorit, i cili absorbon dhe punëson pjesën më të madhe të të rinjve.

Për të rinjtë, ndjekja e arsimit është procesi kryesor që konkurron me angazhimin në aktivitetet ekonomike: pothuajse dy të tretat (65.9%) nga personat jo aktivë ekonomikisht në grupmoshën 15-29 vjeç janë jo aktivë për shkak të regjistrimit në arsim dhe trajnim. Për të rejtat, krijimi i familjes dhe punët shtëpiake (18.5%) janë karriera shtesë siç pasqyrohet në përqindjen që nuk punon për shkak të punëve shtëpiake (18.5 përqind). Gjithashtu të dekurajuarit nga tregu i punës (7.2%) dhe arsye të tjera të panjohura ndikojnë mungesën e pjesëmarrjes në tregun e punës (INSTAT, 2015).

Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve⁶ deklaroi që 29% e personave të vetëpunësuar janë të rinj. Ndërkohë, 18 nga 33 të rinj kanë krijuar start-upe me mbështetjen financiare të shtetit⁷. Këto të dhëna të mbledhura përmes kërkesave për informacion duken interesante por përfundimisht nuk mund të përshkruhen si inkurajuese për sipërmarrjen pa pasur një bazë krahasimore.

Analiza mbi punësimin është e parë në tre këndvështrime: së pari, sektori primar llogarit më shumë vende pune, por zë një peshë shumë të vogël në PBB – kështu ka vende pune pak të paguara dhe me kushte që janë jo tërheqëse për të rinjtë. Së dyti, vendi kaloi një proces deindustrializimi, çka bëri që një pjesë e madhe e popullsisë që punonte në sektorë të caktuar të mbetej e papunë. Konkluzioni i tretë është që industria e shërbimit, kryesisht turizmi por dhe ndërtimi të ndikohen rëndë nga kriza financiare në Europë, e cila preku dy partnerët kryesorë të biznesit të Shqipërisë, Italinë dhe Greqinë. Disa sfida lindën në këtë kontekst: Si të krijohen vende pune që kërkojnë një nivel të lartë arsimit në përshtatje me pritjet e të rinjve që kanë një formim të lartë akademik dhe talent që të ndërpresin procesin e “ikjes së trurit nga Shqipëria”? Si të forcojë sektorin primar me përfitueshmëri në rënie që të përfshijë një pjesë të të papunëve dhe të reduktojë procesin e migrimit nga zonat rurale në ato urbane? Çfarë mund të bëhet për të forcuar sektorin sekondar të ekonomisë, kur fabrikat po zhvendosen dhe të rinjtë dëshirojnë të studiojnë në arsimin e lartë dhe kanë qëllim që të largohen nga vendi qoftë për studime apo punë? A mundet një ekonomi e orientuar nga shërbimi të zhvillohet në një kontekst krize financiare në vendet fqinje?

Fushat kryesore për advokim

Një nga sfidat më të mëdha të pjesëmarrjes ekonomike të të rinjve është papunësia dhe një mospërputhje e madhe midis arsimit, kualifikimit të të rinjve dhe tregut të punës.

⁶ Letër Zyrtare drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve

⁷ Letër zyrtare drejtuar Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes

- Me qëllim krijimin e më sa shumë vende pune dy aksione duhet të ndërmerren: nga njëra anë, të forcohen mekanizmat për kërkimin dhe aksesin në punë, investimi në shërbime profesionale dhe zhvillimi i aftësive punëkërkuese; nga ana tjetër, krijimi i një mjedisi mundësues për zhvillimin e iniciativave të vetë-punësimit, ndërtimi i aftësive sipërmarrëse po ashtu dhe lehtësimi i aksesit në kredi. Është i nevojshme jo vetëm krijimi i më shumë fondeve për start-upe për sipërmarrësit e rinj, por gjithashtu bërja e përpjekjeve në promovimin e këtyre skemave për të gjithë të rinjtë që jetojnë në territorin e Shqipërisë. Gjithashtu, ndërmarrjet sociale përbëjnë shanse për krijimin e vendeve të punës dhe përfshirjen sociale, duke qenë se kombinojnë strategjinë për realizimin e fitimeve me qëllim social. Një njohje e vlerës së shtuar në shoqëri kërkon iniciativa për një trajtim tatimor ligjor dhe fiskal të duhur po ashtu dhe më shumë shanse për financim dhe burime jo financiare.

Ekziston një nevojë për të çuar para barazinë gjinore në tregun e punës. Pavarësisht aprovimit të ligjeve, nevojitet dhe zbatimi i duhur me qëllim arritjen e rezultateve të parashikuara.

- Shërbimet plotësuese duhet ti mundësohen grave me qëllim sigurimin e një shpërndarjeje më të drejtë të punëve midis gjinive. Garantimi i trajtimit të barabartë në rregullore është pika fillestare, por përpjekjet suplementare duhet të konsiderohen. Shërbimet e arritshme dhe të përballueshme për fëmijët dhe kujdesin ndaj të moshuarve si dhe mekanizmat e balancimit të përgjegjësive në familje dhe punë duhet të jenë të përcaktuara. Pagat e barabarta për vende pune të njëjta duhet të respektohen. Një proces i qëndrueshëm dhe i gjatë i fuqizimit të grave duke filluar nga shkolla duhet të ndërmerret me qëllim kundërbalancën e kulturës maskiliste të dominuar në tregun e punës. Kështu do të rritej aksesin e grave në pozicione më të larta. Aksesi në kredi në teori është i garantuar për të dyja gjinitë në mënyrë të barabartë, por në praktikë gratë nuk kanë mundësi për kolateral në pjesën më të madhe të rasteve, duke qenë se prona është regjistruar në emër të kryefamiljarit – në 90% të rasteve prona është në pronësi të burrave (BERZH, 2016) – reformat në këtë aspekt janë konsultuar gjithashtu.
- Programe si “kthimi i trurit” janë duke prodhuar efekte pozitive por mund të shkaktojnë efektin e kundërt nëse nuk implementohen siç duhet. Duhet të konsiderohet zhvillimi i mëtejshëm dhe një vëmendje e kujdesshme e këtyre iniciativave.
- Edhe pse lëvizja e kooperativave nuk është perceptuar mirë pas epokës komuniste, fuqizimi dhe koordinimi i prodhuesve të vegjël në rajone rurale duhet të rikonceptohet.

Modernizimi i shfrytëzimit të tokës do të kontribuonte në ngadalëzimin e procesit të migrimit nga zonat urbane në ato rurale, të cilat në të njëjtën kohë influencojnë rritjen e varfërisë në zona urbane.

- VET duket si një mundësi premtuese për ndërtimin e aftësive dhe kompetencave të rinjve sipas nevojave të tregut të punës. Një vend me burime të afta humane është më i prirur të mbajë fabrikat dhe të tërheqë investime për zhvillim të mëtejshëm. Kështu, do të shoqërohej me krijimin e vendeve të punës. Turizmi dhe ndërtimi do të përfitonin nga programet VET dhe po ashtu profesionistët do të mund ti bënin ballë kërkesës gjatë sezonit turistik. Gjithashtu do të ketë më shumë punonjës profesionistë që përputhen me kërkesat e ndërtimit kur ky sektor të rritet. Një dialog në tregun e punës midis aktorëve kryesorë, hartuesve të kurrikulës së VET, ligjvënësve dhe institucionet zbatuese duhet të promovohet me qëllim përshtatjen me ofertën e kurseve dhe kompetencat që ata ofrojnë në tregun, kështu forcimi i punësimit të pjesëmarrësve në programet VET.

Referenca

- Boka, M. and Torluccio, G. (2013), *Informal Economy in Albania*, within Academic Journal of Interdisciplinary Studies
- Banka Botërore (2013). Retrieved from <http://web.worldbank.org/WBSITE/EXTERNAL/TOPICS/EXTSOCIALPROTECTION/EXTSF/0,,contentMDK:20663797~menuPK:6344572~pagePK:148956~piPK:216618~theSitePK:396378,00.html>
- BERZH (2016) Strategjia për Shqipërinë
- CRCA (2015), Pjesëmarrja e të Rinjve në Politikë dhe Vendim-marje në Shqipëri 2011-2015
- Council of Europe (2012) Youth Policy in Albania.
- European Commission (2014) EU Youth Strategy, retrieved from: http://ec.europa.eu/youth/policy/implementation/work_en.htm
- Friedrich Ebert Foundation (2015), Lost in Democratic Transition? Political Challenges and Perspectives for Young People in South East Europe.
- Friedrich Ebert Foundation (2013), “Rinia Shqiptare 2011: Midis Besimit për të Ardhmen dhe Dyshimit!”
- Freedom House, Albania country report 2014, nga: <https://freedomhouse.org/report/freedom-world/2014/albania>
- IDM, Indeksi i Shoqërisë Civile për Shqipërinë (Tirana, 2010)
- INSTAT (2015), Të Rinjtë në Shqipëri: Sfidat në kohët që ndryshojnë
- INSTAT (2015), Tregu i Punës 2015, nga: http://www.instat.gov.al/media/328212/tregu_i_punes_2015_.pdf
- INSTAT (2016), Popullsia e Shqipërisë 2016, nga: http://www.instat.gov.al/media/322938/pop_1_janar_2016.pdf
- Ministri e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë (2015) Plani Kombëtar i Veprimit për Rininë 2015-2020, Url: http://www.sociale.gov.al/files/documents_files/plani_kombetar_i_veprimit_per_rinine_shqip.pdf
- PNUD (2012), Romët në Shqipëri
- PUND (2015), Raporti Kombëtar i Zhvillimit Njerëzor
- Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2014-2020 (Tirana, 2013) http://www.mod.gov.al/images/PDF/strategji2016/SKZHI_FINAL_QBZ.pdf

- Ministri e Integritit (2015) Strategjia e BE për Shqipërinë 2014-2020, Url:
<http://www.integrimi.gov.al/al/dokumenta/dokumente-strategjike/dokumenti-strategjik-kombetar-2014-2020&page=1>